



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01Nr.06- 23791 /2025

Datë: 04, 08 /2025

*Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VII-të të rregullt për vitin 2025, të mbajtur me datën: 31.07.2025 mori këtë:*

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për ri-alokim të mjeteve buxhetore brenda OB nga kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale Burimi i financimit (10)
2. Nga programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), nga projekti “Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogradjë-Ujmirë), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bardhe”, kodi i projektit 56096, shuma **30,000.00 €**;
3. Mjetet buxhetore si në nenin 2 të këtij vendimi ri-alokohen në:
  - 3.1 Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), në projektin “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët, kodi i projektit 56106, shuma **10,000.00 euro**.
  - 3.2 Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), në projektin “Bashkëfinancim me donatorë”, kodi i projektit 48267, shuma **20,000.00 euro**
- **Arsyetim: rialokimi brenda programit bëhet për harmonizimin e mjeteve për përfundimin e punëve sipas kontratave.**

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

***Me këtë vendim njoftohen:***

- ***MAPL;***
- ***Kryetari i Komunes;***
- ***Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;***
- ***Zyra për Informim;***
- ***Arkivi.***



**Kryesues i Kuvendit**  
**Fadil Gashi**